



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 905/25
Data 22.08.24



Prishtinë, 07 gusht 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2230_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenin 25, Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084); Dispozitat e Nenit 23, Paragrafi 7 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L – 085); Dispozitat e Nenit 11, paragrafët 10.2.1, 11.1.1, 11.2.1 dhe 11.5.1 të Rregullave të Tregut; Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT SH.A.), të datës 30.06.2023, nr. prot. 1234, për shqyrtim dhe aprovim të Procedurës së Rregullave të Tregut për Nominimet.

në seancën e mbajtur me datë 07 gusht 2024, nxori këtë:

VEN DIM

I. **APROVOHET** - Procedura e Rregullave të Tregut për Nominimet.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme ZRRE) më datë 30.06.2023 ka pranuar nga Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut KOSTT SH.A., (në tekstin e mëtejme: KOSTT), kërkesën për shqyrtim dhe aprovim të Procedurës së Rregullave të Tregut për Nominimet.
- Duke pasur parasysh se në të njëjtën kohë KOSTT ka inicuar edhe ndryshime në Rregullat e Tregut, atëherë procedura ka mbetur në pritje dhe, më datë 24.01.2024, pas kërkesës së Rregullatorit për sqarime, KOSTT edhe njëherë përmes emailit rikonfirmoi se ndryshimet në Rregullat e Tregut nuk implikojnë ndryshime në procedurat e dërguara më herët në ZRRE për aprovim dhe ka kërkuar nga ZRRE shqyrtimin dhe aprovimin e kësaj procedure.
- Procedura e Rregullave të Tregut për Nominimet është përpiluar në përputhje me paragrafët 11.1.1, 11.2.1, 11.5.1 dhe 10.2.1 të Rregullave të Tregut që janë përgatitur në përputhje me Nenin 23 (paragrafi 7) të Ligjit Nr. 05/L -085 për Energjinë Elektrike.
- ZRRE, në përputhje me Nenin 27 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, me datë 7 shkurt 2024, ka vendosur në konsultim publik dokumentin, Procedura e Rregullave të Tregut për Nominimet, duke ju ofruar mundësinë të gjitha palëve të interesit të ofrojnë komentet e tyre brenda 15



ditëve nga data e publikimit.

- Gjatë fazës së konsultimeve nuk janë pranuar komente nga palët e interesuara, e po ashtu nga ZRRE nuk ka pasur komente tjera, përveç përmirësimit të referencave ligjore në dokument dhe është kërkuar nga KOSTT që të bëjë përmirësimet e duhura në dokument.
- ZRRE, pas analizimit dhe vlerësimit të Procedurës së Rregullave të Tregut për Nominimet dhe pas përfshirjes së komenteve ka vlerësuar se i njëjti është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe i harmonizuar me Rregullat e Tregut.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe shqyrtimit të Procedurës së Rregullave të Tregut për Nominimet duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Vendimit i bashkëngjitet:

- Procedura e Rregullave të Tregut për Nominimet.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullaku, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar

Arta Isufi, Anëtare


Adrian Preniqi, Anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KOSTT Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji